



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE OKOLINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	DMMU
Nr. i Prot. Prot. No.	7055-2/19
Nr. i Faqes Pr. Stronica No. Pages	-06-
Date	02.04.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.02.2025
REFERENC-Ë:	24/7055/689/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Rahoveci Solar Energy Park" shpk - Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D Sekretarit të Përgjithshëm të MPMHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 24/7055/689/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Rahoveci Solar Energy Park" shpk - Prishtinë, pajiset me Pëlqim Mjedisor për Parkun Solar "Rahoveci Solar 1B" me kapacitet 9.380 MW, në Z.K. Rahovec.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 5 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4, nenit 14 paragrafi 5 dhe nenit 18 të Ligjit Nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania “Rahoveci Solar Energy Park” shpk - Prishtinë, pajiset me Pëlqim Mjedisor për Parkun Solar “Rahoveci Solar 1B” me kapacitet 9.380 MW, , në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec, nën kushtet si vijon:

Gjatë fazës së ndërtimit:

- Gjatë fazës së Vendosijes të Paneleve Diellore Fotovoltaike “Rahoveci Solar 1B” me kapacitet 9.380 MW, në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec, të respektohen normat e shkarkimeve në ajër nga automjetet me të cilat transportohen pajisjet e nevojshme si dhe të kontrollohet niveli i zhurmës dhe sasia e pluhurit që krijohen si pasojë e qarkullimit të automjeteve të rënda

Faqe 2 nga 6



- Gjendja infrastrukture jashtë lokacionit të Vendorsjes të Paneleve Diellore Fotovoltaike "Rahoveci Solar 1B" me kapacitet 9.380 MW, në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec, e cila përdoret gjatë fazës së vendorsjes duhet të mirëmbahet. Minimizimi i pluhurit në duhet të bëhet duke i spërkatur vazhdimisht me ujë.

Gjatë fazës së operimit

- Parku Solar "Rahoveci Solar 1B" me kapacitet 9.380 MW, në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec.

Emisionet në ajër

- Masat për mbrojtjen e ajrit duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Të respektohet Direktiva për ruajtjen e zogjëve të egër 79/409/EC

Menaxhimi mbeturinave

- Menaxhimi i mbeturinave, duhet të bëhen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina;

Rastet aksidentale

- Të përgatitet dhe zbatohet plani për raste të aksidenteve mjedisore bazuar në legjislacionin në fuqi;
- Të bëhet rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara , sipërfaqet e rehabilituara të mbjellen me barë duke ju përshtatur mjedisit rrethues;
- Me kushtet e përcaktuara në vendimin e pëlqimit mjedisor operatori detyrohet që pas ndërprerjes përfundimtare të funksionimit të Vendorsjes të Paneleve Diellore Fotovoltaike "Rahoveci Solar 1B" me kapacitet 9.380 MW, në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec, të planifikoi masat për dekomisionimin dhe për rehabilitimin e vendndodhjes së tij;
- Ndalohet veprimtaria e Kompanisë "Rahoveci Solar Energy Park" shpk - Prishtinë, pajiset me Pëlqim Mjedisor për Parkun "Rahoveci Solar 1B" me kapacitet 9.380



MW, në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec, në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.

- Kompania "Rahoveci Solar Energy Park" shpk – Prishtinë, duhet instaluar shtresa antirefleksive në modulet solare duke vendosur qelqe ballore speciale për të ndaluar reflektimin e dritës.
- Kompania "Rahoveci Solar Energy Park" shpk – Prishtinë, pajiset me Pëlqim Mjedisor për Parkun Solar "Rahoveci Solar 1B" me kapacitet 9.380 MW, në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec, duhet të i plotësoi kushtet e parapara në Raportin e VNM-së, për të plotësuar kushtet mjedisore të parapara me Legjislacionin në fuqi.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartëcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga kompania "Rahoveci Solar Energy Park" shpk - Prishtinë, pajiset me Pëlqim Mjedisor për Parkun Solar "Rahoveci Solar 1B" me kapacitet 9.380 MW, në ngastrat P-71510057-02299-0 dhe P-71510057-02302-1, në Z.K. Rahovec, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet , konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/7055/ - ZSP/ /25 datë: 14.02.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Divizionit për komunikim me publikun
6. Arkivit të MMPHI
7. Komunës së Rahovecit

Izedin B. Ryqi

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI



2. SHTOICË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

